KM-MI 507/17
01+98 06/12/17

MINISTRY OF INFRASTRUCTURE
01 9193
01 + SHT 06.12.17

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Infrastrukturës*
*Ministarstvo Infrastrukture*
*Ministry of Infrastructure*

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës , në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) , të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, datë 21 tetor 2010) , bazuar në dispozitat e nenit 61, paragrafi 3, të ligjit nr. 04/L-63 për hekurudhat e Kosovës, dhe nenit 8 paragrafi 3, të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive ,merr:

## VENDIM

I. Miratohet struktura e sistemit të vendosjes së çmimit për shfrytëzuesit e rrjetit dhe nivelin e përgjithshëm të pagesave të shfrytëzimit të infrastrukturës hekurudhore, e përcaktuar në Ekspozeun e rrjetit 2018.

II. Numri i vendimit, dhe modifikimet e ndryshme shënohen në tabelën e modifikimeve të Ekspozeut të rrjetit.

III.Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit

Pal LEKAJ
Ministër i MI-së

**Vendimi u dërgohet:**

-Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik,
- Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave,
-INFRAKOS-it,
-TRAINKOS-it,
- Departamentit të Transportit Tokësor dhe
- Arkivit të MI-së